Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission

# Manual për përdoruesit e Autoriteteve Kontraktuese

## Ndryshimet/përditësimet në sistem të prokurimit elektronik ( nga data 01.11.2022)

Nëntor, 2022

# Ndryshimet/përditësimet në detajet e procedurave

Ky manual udhëzues i dedikohet zyrtarëve të prokurimit të të gjitha Autoriteteve Kontraktuese për të kuptuar përmbajtjen e ndryshimeve dhe përditësimeve të fundit të bëra në sistem të prokurimit elektronik dhe të cilat janë vënë në përdorim nga data 01.11.2022.

Kryesisht përditësimet kanë të bëjnë më së shumti me një strukturim apo ri-strukturim të të gjitha dokumenteve që janë pjesë e një aktiviteti të prokurimit dhe të cilat janë pjesë e detajeve të procedurës.

Më poshtë në mënyrë ilustrative do të sqarohet përmbajtja e ndryshimeve dhe do të përshkruhen shkurtimisht udhëzimet lidhur me përdorimin e funksioneve të reja të përfshira në këto ndryshime.

Siç ka qenë deri më tash, secili aktivitet i prokurimit i përgaditur dhe publikuar nga zyrtarët e prokurimit të Autoritetit Kontraktues përmbanë detajet e aktivitetit/procedurës, si në fig më poshtë:

**<u>Detajet e procedurës së prokurimit:</u>**




Lista e skedarëve/folderëve të ri-strukturuar në detaje të procedurës.

**Skedari/Folderi "Njoftimet"** përmbanë të gjitha njoftimet ( Njoftimin Paraprak, B05, B08, B54, B52, etj) të publikuara në procedurën përkatëse, të cilat janë publike dhe të shkarkueshme nga cilado palë.

**"Dosja e Tenderit"**




**Skedari/Folderi "Dosja e Tenderit"** përmbanë të gjitha dokumentet e publikuara gjatë përgaditjes së procedurës, Dosjen e Tenderit, Përshkrimin e çmimeve, dhe ndonjë dokument të publikuar si dokument shtesë tek dosja e tenderit. Duhet theksuar që me ndryshimet e reja, Njoftimi mbi Vendimin e AK (B58) nuk publikohet më si dokument shtesë tek DT, por publikohet nëpërmjet butonit/funksionit" Publikimi i B58" – publikim që do të sqarohet më poshtë.

## “Ofertat”




**Skedari/Folderi “Ofertat”** përmbanë të gjitha ofertat e dorëzuara/pranuara për aktivitetin e prokurimit. Ofertat e dorëzuara/pranuara janë të dukshme vetëm pas përfundimit të procesit të hapjes së ofertave nga ana e AK.  Me ndryshimet e përfshira, të gjitha ofertat e dorëzuara/pranuara janë të dukshme në pjesën e AK, derisa në pjesën e ofertuesit është e dukshme vetëm oferta e dorëzuar nga ofertuesi.

## “Sqarimet e DT”



**Skedari/Folderi "Sqarimet e DT"** përmbanë të gjitha "kërkesat për sqarime të DT" të dërguara nga ofertuesit potencial, dhe përgjigjet e publikuara nga ana e AK në "kërkesa për sqarime të DT".

AK nga kjo pjesë vetëm mund të shkarkojnë "kërkesën për sqarime të DT", derisa përgjigjen duhet ta bëjnë nëpërmjet funksionit/butonit " Sqarimet e DT", buton nga I cili edhe mund të bëjnë shkarkimin e kërkesës gjithashtu.

**<u>"Kërkesat për ri-shqyrtim"</u>**




**Skedari/Folderi "Kërkesat për ri-shqyrtim"** përmbanë të gjitha "Kërkesat për ri-shqyrtim" të dërguara nga ofertuesit dhe të gjitha përgjigjet/vendimet e AK në "Kërkesat për ri-shqyrtim" për procedurën përkatëse të prokurimit.

AK nga kjo pjesë vetëm mund të shkarkojnë "kërkesën për rishqyrtim", derisa përgjigjen duhet ta bëjnë nëpërmjet funksionit/butonit " Kërkesat për Rishqyrtim", buton nga i cili edhe mund të bëjnë shkarkimin e kërkesës gjithashtu.

## “Dokumentet-Letrat standarde”




Skedari/Folderi “Dokumentet-Letrat standarde” përmbanë të gjitha letrat standard të derguara tek ofertuesit pas përmbylljes së procesit të hapjes së ofertave. Gjithashtu përmbanë edhe përgjigjet/dokumentet e ofertuesve në letrat standarde të AK.

Nëse AK duhet të dërgojë një letër standarde tek ofertuesit, atëherë nëpërmjet funksionit +(shto dokument të ri) përzgjedh nga lista letrën standard të cilën ka për qëllim ta dërgoj tek cilido ofertues që ka dorëzuar ofertë. Pas përzgjedhjes së Letrës Standarde, hapet mundësia për ngarkimin e LS dhe dërgimin tëk ofertuesi i përzgjedhur.

Shablloni i Letrave Standarde mund të përgaditet nëpërmjet funksionit “krijo” tek pjesa e “dokumenteve tjera në procedurë” apo në të njejtën mënyrë si ka qenë deri më tash.

**<u>“ Procesverbali, Raporti I Vlerësimit, Vendimi B58”</u>**




Skedari/Folderi **“ Procesverbali, Raporti i Vlerësimit, Vendimi B58”** përmbanë dokumentet e Procesverbalit të Hapjes së ofertave (B12), Raportin e Vlerësimit të ofertave ( pasi të krijohet raporti) dhe Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) – I cili publikohet nëpërmjet butonit ‘Publikimi i B58).

Procesverbali i Hapjes së Ofertave (B12) dhe Njoftimi mbi Vendimin e AK (B58) janë dokumente publike dhe të qasshme nga të gjitha palët.

**“Dëshmitë e pranueshmërisë”**




Skedari/Folderi “Dëshmitë e pranueshmërisë” përmbanë dokumentet e pranueshmërisë të kërkuara nga AK dhe të dërguara nga Ofertuesi.

Kërkesa nga ana e AK bëhet nëpërmjet funksionit “dërgo dokument tek OE” në pjesën e Dokumenteve-Letrave Standarde”, derisa OE dërgon dokumentet në të njejtën mënyrë tek AK.

**“Deklarata e Nevojave B04”**




Skedari/Folderi “Deklarata e Nevojave B04” përmbanë dokumentet mbi deklaratat e nevojave B04 të krijuara dhe ngarkuara gjatë përgaditjes së procedurës së prokurimit dhe deklaratës së rikonfirmuar në fazën përkatëse.

**<u>"Komunikim me Monitorim/KRPP"</u>**




Skedari/Folderi **"Komunikim me Monitorim/KRPP"** ofron mundësinë e pranimit të dokumenteve/kërkesave, etj nga monitorimi i KRPP lidhur me procedurën e prokurimit, dhe ofron gjithashtu mundësinë e dërgimit të dokumenteve/përgjigjeve, etj në monitorimin e KRPP.

Të gjitha dokumentet/komunikimet e shkëmbyera do të jenë të regjistruara në ketë pjesë dhe do të jenë në disponueshmëri për shkarkim gjithashtu.

## “Dokumentet lidhur me kontratat”




**Skedari/Folderi “Dokumentet lidhur me kontratat”** përmbanë “kontratën ose kontratat e nënshkruara” për procedurën e prokurimit, përfshirë draft-kontratat e përgaditura dhe shkëmbyera me ofertuesin e zgjedhur.

## Ndryshime/Përditësime të tjera

Në kuadër të ndryshimeve të tjera, AK duhet patur parasyshë që **formati i çmimeve** të vendosura gjatë përgaditjes së procedurës së prokurimit dhe zhvillimit të procedurës gjithashtu **duhet** të jetë kështu: **123,456,789.00** ose si ne fig më poshtë:

